



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 147 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 10 / 2023

VENDIM

Nr. 37 date 25 / 10 / 2023

PËR

PROJEKT IDENE E OBJEKTIT

“RIKONSTRUKSIONI I SHKARKUESIT TE REZERVUARIT BOZANXHIE-ZHURJE”,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.10.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane per Rikonstruksionin e Shkarkuesit te Rezervuarit te Bozanhies-Zhurje e cila administrohet nga kjo Bashki. Kjo dige me lartesi 21 m eshte ndertuar ne vitin 1974 dhe ka krijuar nje rezervuar uji me volum aktual prej 304 600 m3.


Projekt Ideja është përgatitur nga firma konsulente Viante Construction dhe Net Group shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se projekti i ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit të mesipër si dhe të nenit 8 të VKM se mesipërme. Projekti ideja e paraqitur Relacionin teknik, studimin gjeologjik, topografik, batimetrik, hidrogeologjik dhe hidrologjik si dhe VNM, analizen e vales vershuese, hartat e permbytjeve, Planin e gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per shkak te prishjes se mundshme te diges te cilat japin nje pasqyre te plote te problematikave dhe sherbejne si nje baze te mire per analizen e kryer ne kete drejtim. Ne dokumentacionin e paraqitur, mungojne zeri I punimeve per FV te sistemit te alarmit gje e cila eshte nje kerkese ligjore per te gjitha digat e medha dhe ne menyre te vecante per digat qe rrezikojne jeten e njerezve qe ndodhen ne zonat urbane poshte tyre.

Duke qenë se poshte kesaj dige ndodhen afro 45 ndertesa dhe afro 150 banore, instalimi i sistemit te alarmit eshte i nevojshem. Sipas projekt idese jane parashikuar te kryhen punime per rindertimin e shkarkuesit, rehabilitimin e sistemit te drenazhit, vepres se marrjes, mbrojtjen e anes se sipërme dhe te poshtme te diges, mbrojtjen e kurores se diges si dhe ndertimi i rruges per rreze dige dhe ndertimi i dhomes se sherbimit. Projekt ideja parashikon FV te sistemeve te monitorimit gjeodezik, hidrogeologjik, HM dhe hidraulik.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të miratoj Projekt Idene e paraqitur. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Projekt Idene per Rikonstruksionin e shkarkuesit te diges se Rezervuarit Bozanhie-Zhurie dhe te vazhdoj me përgatitjen e Projektit të Zbatimit per punimet e parashikuara ne Projekt Idene e paraqitur.
- 2- Ti kërkoj Bashkisë Tirane dhe firmës projektuese qe gjate përgatitjes se projekt zbatimit per rikonstruksionin e shkarkuesit te kontrollohet permasimi i kapacitetit te shkarkuesit per shkarkimin e prurjeve ditore qe mund te vijne ne kete rezervuar nje here ne 1000 vjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 3- Ti kërkohet Bashkise Tirane qe projekti i zbatimit per rikonstrukcionin e shkarkuesit te diges se Bozanhies i plotesuar sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe kerkesave te mesiperme, te dorezohet prane KKDM perpara fillimit te punimeve ne terren,
- 4- Ti kërkoj Bashkise Tirane qe para fillimit te punimeve **te merren masat per boshatisjen e rezervuarit si dhe te marre miratimin e KKDM per mbikqyresin e punimeve te caktuar prej saj sipas legjislacionit te mesiperm**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

